



Republika e Kosovës


Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Për :	Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës së Obiliqit Burim Gërguri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Obiliqit	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë Sekretari i Përgjithshëm i ME	
Përmes:		
Nga:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë: 20.05.2021
Zyrtarët përgjegjës:	Venera Çerkini Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	VI-020-414/3
Lënda:	Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë së aktit të Komunës së Obiliqit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, Vendimin Nr. I-67 formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Kompanisë KRM "Pastrimi", miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliqit, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Obiliqit, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e lartshënuar e kemi dërguar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës si institucion përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë.

Bashkangjitur gjeni raportin e vlerësimit të Ministrisë së Ekonomisë



RE-PUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT	
MINISTRIA E EKONOMISE MINISTARSTVO EKONOMIJE MINISTRY OF ECONOMY	
Njësia Org. Org. Unit	Nr. Prot. Prot. No.
01/3	1292
Nr. i Javës Org. Reference No. i referenc.	Data Datum Date
2	18.05.21
PRISHTINE A NO. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria
Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING			
REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVES/VLADA/KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarstvo Lokalne Samouprave / Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum Date	20.05.2021		
Niveli organizativ Org. Unit	Nr. i Lëvizjes Mvt. No.	Shtojca Attachment	Vlera Value
	VI-020-414/3		

DATA	18.05.2021
PËR/ZA/TO:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave/MAPL
CC:	Kryetar i Komunës së Obiliqit Trim Berisha, zv.Sekretar i përgjithshëm/MAPL Fatos Qerimi, Sekretar i përgjithshëm/MEA Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave/MAPL Ardita Latifi, Zyrtare e lartë për Monitorim të Komunave/MAPL
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Besim Imeri, Udhëheqës i NJPMNP-së <i>Besim Imer</i>
NGA/OD/FROM:	Arbërore Bernica-Hasani, Analiste/NJPMNP <i>Arbërore Bernica-Hasani</i>
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vlerësimi i ligjshmërisë të aktit të Komunës të Obiliqit

E ndëruar.

Në pajtim me Rregullore (QRK) Nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë së Ekonomisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullore (QRK) - Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, NJPMNP/ME ka pranuar për shqyrtim aktin komunal në vijim:

Vendimi i Kuvendit të Komunës së Obiliqit i miratuar me datë 30.04.2021, i pranuar në ME-a nga MAPL me datë 14.05.2021 Nr. prot.020-414/2, për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve në KRM "Pastrimi sh.a" Obiliq, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Obiliq nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Obiliqit me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Mbështetur në ligjin nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike neni 5 paragrafi 2 rregullon " Kur një komunë është aksionar në një NP Lokale, i cili përbëhet nga (i) një anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës dhe (ii) dy anëtarë të tjerë të emëruar nga Kuvendi Komunal. Për këtë qëllim, Komisioni Komunal i Aksionarëve ka të drejtë të veprojë në emër të Komunës përkatëse dhe duhet të veprojë në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Çdo Komision Komunal i Aksionarëve duhet, me shumicë të thjeshtë votash, të vendosë se si do t'i ushtrojë të drejtat e aksionarit të komunës në një çështje të caktuar."

Ministria e Ekonomisë, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekt juridike. Ministria e Ekonomisë, mbetet në dispozicion të MAPL dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

Respekt!